

**URDHËR**  
**Nr. 150, datë 3.4.2018**

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 344, DATË 19.8.2013, “PËR NGRITJEN E NJËSISË SË SHËRBIMIT PSIKOSOCIAL”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 20, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 175, datë 8.3.2017, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 13.9.2017, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”,

**URDHËROJ:**

1. Shkronja “b”, e pikës 5, e urdhrit nr. 344, datë 19.8.2013, ndryshon si më poshtë: “Në institucionet e arsimit të mesëm të lartë të sigurohet një psikolog dhe një punonjës social për 1800–2300 nxënës, ndërsa për çdo institucion të arsimit të mesëm të lartë të llojit gjimnaz me mbi 700 nxënës të sigurohet një psikolog ose një punonjës social.

2. Numri i punonjësve të shërbimit psikosocial, që shtohen në zbatim të këtij urdhri, të bëhet brenda numrit të punonjësve mësimorë, të miratuar për vitin 2018, për çdo drejtori arsimore rajonale dhe zyrë arsimore”.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, njësitë arsimore vendore.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT  
DHE RINISË  
**Lindita Nikolla**